

## **Zamira Alimemaj**

Department of Foreign Languages  
University “Ismail Qemali” Vlorë, Albania

## **Kozeta Hyso**

Department of Foreign Languages  
University “Ismail Qemali” Vlorë, Albania

# **Huazime ballkanase në leksikun e labërishtes**

*Gjuha, si pjesë përbërëse dhe tipar dallues i etnokulturës së një populli nuk është statike; ajo vazhdimisht evoluon, pasurohet, pasqyron përjetimet e ndikimin e faktorëve jashtëgjuhësorë (historikë, gjeografikë, politikë, ekonomikë dhe etnokulturorë) dhe zhvillohet, ndryshon e përparon, duke qenë kurdoherë e varur nga ecuria e zhvillimit ekonomik, nga gjendja dhe ndryshimet sociale të populli, që është krijuesi dhe mbartësi i saj, natyrisht edhe nga fqinjësia e marrëdhëniet me gjuhët e kulturat e popujve të tjerë. Gjuha shqipe ka dy dialekte kryesore: gegërishten dhe toskërishten. E folmja e krahinës së Labërisë shqyrtohet si pjesë përbërëse e toskërishtes jugore dhe ka një leksik të pasur; i cili, përveç veçorive individuale që shfaq, ka edhe tipare të përbashkëta me të folmet e tjera të toskërishtes, sidomos për sa u përket huazimeve. Qëllimi i këtij punimi është të prezantojë disa ndikime ballkanase që i gjejmë në leksikun e labërishtes.*

**Fjalët kyç:** labërishtja, dialekte, gegërishtja, toskërishtja, shqipja, huazime ballkanase, leksiku.

## **Hyrje**

Gjuha, si pjesë përbërëse dhe tipar dallues i etnokulturës së një populli nuk është statike; ajo vazhdimisht evoluon, pasurohet, pasqyron përjetimet e ndikimin e faktorëve jashtëgjuhësorë (historikë, gjeografikë, politikë, ekonomikë dhe etnokulturorë) dhe zhvillohet, ndryshon e përparon, duke qenë kurdoherë e varur nga ecuria e zhvillimit ekonomik, nga gjendja dhe ndryshimet sociale të populli, që është krijuesi dhe mbartësi i saj, natyrisht edhe nga fqinjësia e marrëdhëniet me gjuhët e kulturat e popujve të tjerë. Edhe gjuha e kultura popullore e shqiptarëve, natyrisht, edhe me ndikimet e

pamungueshme të veçorive të secilës bashkësi shoqërore a krahinore të caktuar, në tërësinë e saj, sikundër e kanë vërtetuar edhe studimet e historianëve më të autoritetshëm, kanë përbërë dëshmi të rëndësishme të vlerave e të tipareve etnike e kombëtare të shqiptarëve. Rasti e kërkon t'i referohemi për sa më lart një vlerësimi të prof. Aleks Buda, i cili theksonte se “kultura popullore shqiptare është një monument i shpirtit krijues të popullit dhe, për nga shndërrimet që pësoi gjatë përdorimit të saj mund të quhet “prodhim kolektiv” që trashëgohet në formë rregullash të fiksuara, në bazë të traditës së pashkruar, një traditë, prandaj e quajtur, tradicionale” (Buda 1977 :16).

Gjuha dhe kultura e shqiptarëve, lashtësia dhe karakteri origjinal i tyre, kanë tërhequr prej kohësh vëmendjen e studiuesve të huaj dhe shqiptarë, qysh në shekullin XVIII dhe më parë. Në mënyrë të veçantë, gjuha, historia dhe kultura e shqiptarëve, tërhoqi vëmendjen e albanologëve gjermanë. Madje, edhe një filozof i madh, siç ishte Gotfrid Vilhelm Leibnitz, që punoi një shekull para lindjes së gjuhësisë krahasimtare, shfaqti interesim dhe u shpreh, se studimi krahasues i gjuhëve ishte themelor për të ndërtuar një histori universale të botës, për ta kuptuar dhe për ta shpjeguar atë. Në disa letra, që ai i shkruante një bibliotekari të Bibliotekës Mbretërore të Berlinit, në fillim të shekullit XVIII, shprehet edhe për natyrën dhe prejardhjen e gjuhës shqipe dhe pas disa luhatjeve, arriti në përfundimin, se shqipja është gjuha e ilirëve të lashtë.

Megjithatë, studimet shkencore për gjuhën shqipe, si dhe për shumë gjuhë të tjera, nisën pas lindjes së gjuhësisë historike-krahasuese nga mesi i shekullit XIX. Njëri nga themeluesit e kësaj gjuhësie, dijetari gjerman Franz Bopp, arriti të provonte, qysh në vitin 1884, se shqipja bënte pjesë në familjen e gjuhëve indoevropiane dhe se zinte një vend të veçantë në këtë familje gjuhësore. Pas tij, studiues të tjerë, si Gustav Meyer, Holger Pedersen, Norbert Jokli, studiuuan aspekte të ndryshme të leksikut dhe të strukturës gramatikore të gjuhës shqipe.

G. Meyer-i qysh në vitin 1891 hartoi një *Fjalor etimologjik të gjuhës shqipe* (*Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*, Strasburg 1891), i pari fjalor i këtij lloji për shqipen. Përveç këtyre, një varg i madh gjuhëtarësh të huaj, si Franc Miclosich, Gustav Weigand, Carlo Tagliavini, Stuart Man, Eric Hamp, Agnia Desnickaja, Herman Ölberg, Harallamb Mihaescu, Wilfried Fiedler, Oda Bucholtz, Martin Huld, Giovanni Battista Pellegrini etj. kanë dhënë ndihmesa të shënuara për studimin e historisë së gjuhës shqipe, të problemeve që lidhen me prejardhjen e saj, me etimologjinë, me fonetikën dhe me gramatikën historike, si edhe në studimin e gjendjes së sotme të shqipes.

Njohja dhe studimi i dialekteve janë themelore për të gjitha studimet gjuhësore, sepse ato pasqyrojnë të kaluarën e etnisë shqiptare në përgjithësi e

të bashkësive shoqërore të krahinave të caktuara në veçanti (Gjinari, Shkurtaç 2003 :17). Gjuha shqipe ka dy dialekte kryesore: gegërishten dhe toskërishten. Po të ndiqet hap pas hapi lindja dhe zhvillimi i tipareve të dy dialekteve të shqipes, duke nisur nga ato më të rejat e duke shkuar tek ato më të lashtat, shihet se ato së bashku me shumë veçori të të folmeve të veçanta janë forma të ndryshme që ka marrë kohë më kohë brumi i vetë gjuhës shqipe. Në gjuhën shqipe nuk ekzistojnë dallime të rëndësishme cilësore në intonacione dhe dallimi në gjatësinë e zanoreve nuk është absolut e as relevant, sepse zanore të gjata gjenden në gegërishte, por edhe në të folmet e labërishtes, të çamërishtes dhe arbërishtes (të gjitha këto janë të folme të toskërishtes). (Gjinari 1989 :6). Si dialekt, toskërishtja ka nënndarjet e saj, dy nëndialekte: toskërishten veriore dhe atë jugore, që, gjithashtu, janë të përthyer e të përbërë nga të folme e grupe të folmesh me dukuri që nuk përputhen me gjuhën letrare, si labërishtja, çamërishtja e të tjera. (Gjinari, Shkurtaç 2000 :31).

Bërthamën e Labërishtes e përbëjnë të folmet e Kurveleshit, të folmet e tjera afrohen me to por nuk janë krejtësisht të njëjta (Gjinari, Shkurtaç 2003 :163). Ndryshimet që erdhën në jetën ekonomike dhe kulturën shpirtërore si pasojë e zhvillimeve historike si dhe ndikimeve të huaja kulturore në krahinën e Labërisë, u shfaqën edhe në fushën e gjuhës. Kështu, leksiku i përgjithshëm ka humbur fjalë të vjetra të shqipes, por edhe është pasuruar me fjalë të reja, një pjesë e të cilave janë të huazuara. Edhe ajo pjesë e trashëgimisë, e cila është përcjellë gojë më gojë, është prekur nga ky fenomen. E folmja e Labërisë ka një leksik të pasur, i cili, përveç veçorive individuale që shfaq, ka edhe tipare të përbashkëta me të folmet e tjera të toskërishtes, sidomos për sa u përket huazimeve.

Si rrjedhim i kontakteve të ndryshme historike me popuj të ndryshëm dhe i zhvillimeve të brendshme, në kulturën shpirtërore e materiale të Labërisë shumë gjëra kanë ndryshuar dhe më qartë këto ndryshime shfaqen në fushën e gjuhës. Ndryshime të mëdha kanë ndodhur në fushën e emrave të njerëzve (antroponimet) dhe të vendeve (toponimet). Kanë humbur emrat vetjakë të periudhës së lashtë dhe të mesjetës; shumë emra gjeografikë janë zëvendësuar me fjalë të huaja, kurse një pjesë tjetër, duke kaluar gojë më gojë ndër breza, kanë ndryshuar formën fonetike. Edhe në krahinën e Labërisë, toponimia paraqet interes gjuhësor e historik. Toponimet në këtë krahinë flasin për lashtësinë e banorëve, emërtimet e bartura gjatë pushtimeve, evoluimin social, ekonomik, politik e shpirtëror të kësaj treve. Në Labëri, ashtu si në të gjitha trojet shqiptare, shkelën shumë pushtues. Nëpërmjet pushtuesve, u futën në toponiminë dhe antroponiminë e Labërisë një numër i madh emrash të huaj, të cilat ushtruan një trysni në gjuhën vendase. Ndaj kësaj trysnie të huaj, shqipja ka shfaqur gjithnjë qëndresën e saj dhe, kur nuk ka qenë e mundur t'i prapësojë emrat e huaj, së paku i ka përvetuar duke i

shndërruar ato fonetikisht e morfologjikisht e duke ia përshtatur disi natyrës së saj (Shkurtaj 2001 :26).

## Ndikimet e huaja në leksikon e labërishtes

E folmja e Labërisë ka një leksik të pasur, i cili, përveç veçorive individuale që shfaq, ka edhe tipare të përbashkëta me të folmet e tjera të toskërishtes, sidomos për sa u përket huazimeve.

## Huazimet greke

Sfera më pak e prekur nga greqizmat është ajo e blegtorisë, prandaj edhe nga ana hapësinore, pjesa mirëfilli malore e krahinës, ka pasur më pak huazime nga greqishtja; përkundrazi ato janë më të shumta në të folmen e Bregut të Detit, kjo si pasojë e marrëdhënieve të ngushta ekonomike me Greqinë (Korfuzin). Një ndikim të madh në huazimet greke pati hapja e kishave dhe shkollave greke në këtë zonë. Greqizma vërehen më shumë në sferën e detarisë dhe të mjeteve të lundrimit e më pak në sferat e tjera.

Një pjesë e greqizmave, sikundër do të shihet nga lista e mëposhtme, janë të atilla që kanë kaluar edhe në të folme të tjera të toskërishtes, madje, disa edhe më lart në trevat e gegërishtes, si *akoma* (ende), *dhaskal* (mësues), *farmak* (helm), *gjiton* (komshi), *kallamboq* (misër), *psonis* (bëj pazar), *langua* (qen gjahu), *livadh*, *llahtaris* (frikësoj, tremb), *lolo* (budalla), *radhë* (rresht), *sinor* (kufi), *stafidhe* (rrush i thatë) etj. Sidoqoftë, Labëria ashtu si krejt pjesa skajore e Jugut të Shqipërisë ka më shumë huazime greke (Totoni 1964 :12), si p.sh.: *afendiko*, *adhjas* (pastroj), *allonar* (korrik), *avlli* (oborr), *bango*, *cimbis* (pickoj), *cimidh* (mashë), *dhogë* (dërrasë), *eftaristisa* (kënaqa), *faneps*, *farmakos*, *feks* (ndriçon), *fermeridhe* (grindavec), *gremis*, *kallamar* (enë për bojë), *kallogre* (murgeshë), *katandi* (pasuri), *katandis*, *kokalli* (kockë) *ksodh* (vaki, vdekje), *kumbisem* (mbështetem), *kunup* (mushkonjë), *kuturis* (veproj), *kuvli* (kafaz), *lipset* (duhet), *llagariset* (kthjellohet), *mandate* (lajmi i vdekjes), *mballomë* (arnë), *mbodhis* (vonohet), *moleps*, *mollois* (tregoj), *nikoqire*, *nome* (kullotë), *ormis* (përgatit), *pparune* (lulëkuqe), *pataks* (tremb), *patomë* (shputa e këmbës), *podhe* (strehë), *potis* (ujis), *proftas*, *qeramidhe* (tjegull), *qir* (zotëri), *qivur* (arkivol), *rokanis*, *shastis* (humbas), *shpirto* (shkrepse), *sikteris* (përzëskutinë (pelena), *shqepi* (pjesë e verandës), *taksidh* (udhëtim), *thiatro* (teatër), *toidhio* (njëlloj), *trapez*, *zali* (të fikët, vilani), *zileps* etj.

## Toponime që përmbajnë fjalë të huazuara nga greqishtja

Fqinjësia e gjatë me popullin grek dhe marrëdhëniet e dendura ekonomike dhe kulturore me të, kanë ndikuar në huazimin e fjalëve të greqishtes në shqipen dhe, me kohë, mbi bazën e tyre janë formuar edhe emërvende (toponime) jo të pakta të kësaj krahine, si: *Aspropetra* (gur i bardhë), *Andrehora*, *Arvat* (vend në fushë), *Armisidha* (vend i kripur), *Barkole*, *Dhimëkaza* (vend ku vijnë shumë shira), *Frength* (luginë në të cilën gjenden shumë shpella), *Gërmadhë*, *Gjipe*, *Gonë*, (gjiri i Porto Palermos), *Gryka e Stovarfit*, *Hamuriq*, *Jalë* (vend në Vuno, do të thotë qelq, quhet kështu sepse uji është shumë i pastër), *Jalovlash*, *Karidhon* (vend me fruta), *Kastanea*, *Kadafiq*, *Kaliba*, *Kalibaq*, *Katohori*, *Kisha e Klllogjrit* (kallogjer = njerëz që rrinë pranë vendeve të shenjta), *Klllogjri*, *Kondakuvi*, *Kostaraqi*, *Kreta*, *Lithit*, *Livaqi*, *Maja e Kapelit* (kapeli = kapelja), *Maja e Mesunit* (mesa = midis), *Mavrojanji*, *Mavrovë*, *Mavromat*, *Megalihora* (kullotë), *Pajohori*, *Pandelejmon*, *Parikë*, *Përroi i Kalinorit*, *Përroi i Millokopisë*, *Përroi i Lithit*, *Kadafiq*, *Përroi i Millokopisë*, *Përroi i Tramatraqit* (tramatraq = vendkomandë ushtarake), *Potam* (vend ku rrjedh ujë), *Qafa e Spitharit* (spithos = gropëz në gurë me ujë të ndënjur), *Sevaster*, *Spile* (shpellë), *Shpella e Gramës* (grama = shkrim), *Shpella e Katafiqe* (humnerë), *Shtegu i Dhimës*, *Thekër*, *Thodhos*, *Vendero*, *Visha* (qafë).

## Huazimet sllave

Huazimet sllave gjenden me shumicë në leksikon bujqësor e blegtoral, por edhe në atë të përgjithshëm, si p.sh.: *bejkë*, *belec*, *bran* (zvarrë), *branis*, *brashnje*, *breg*, *dërstilë*, *gjinë* (argjil), *kosore*, *koritë*, *lesë*, *luath* (livadhe), *mezhdë*, *gorricë*, *kërmë*, *kllçoçkë*, *kolibe*, *kosh*, *koshere*, *kopaçe*, *kovaç*, *kotec*, *kovë*, *kurvë*, *lopatë*, *lugat*, *memeç*, *moqilë* (hauz), *mogile* (varr), *stan*, *sokëllin*, *shparth* (lloj dushku), *tërkuzë*, *velënxë*, *vërvit*, *vërsnik* (moshatarë), *zbraz*, *zvor* (burim), *zhiva* (helm), *zakon*, *dorovit*, etj.

Nga huazimet sllave që janë më të rralla, mbase edhe krejt të panjohura në të folmet e tjera të shqipes, mund të përmendim: *bigorr* (çmërs), *cfrat*, *cipal*, *çelnik* (kryetar i barinjve), *çetur*, *darovë* (dhuratë), *drënjë*, *gërrec*, *kapicë*, *kobë*, *kobit*, *krinë*, *latë*, *meçkë*, *mrezhë*, *pestrovë* (troftë), *ponovë* (tokë e punueshme), *rezhdë*, *selit*, *tërsirë*, *vidhër* (kastor), *rrazhdë* (hoje të prishura), *roit*, *vockë* (enë druri), *zhivar*, *bist*, *bistër* (e thartë), *buhavitet* (fryhet), *fertile* (copë e çikë), *çetë* (grupë njerëzish), *godis* (qëlloj), *tutkun*, *vockë* (enë uji).

## Toponime që përmbajnë fjalë të huazuara me origjinë sllave

Shumica e emërtimeve të fshatrave të krahinës dhe një pjesë e konsiderueshme e mikrotoponimeve që lidhen me jetën e përditshme të fshatarëve janë të formuara me fjalë të huazuara nga sllavishtja, ku shquajnë ato me prapashtesat **-ic(ë)**, **-ov** dhe me leksik të ditur si i origjinës sllave, si *voda*, *bërda*, *grad* etj. Kjo është e kuptueshme, sepse sipas Sh. Demirajt: “Prania e një numri të madh toponimesh sllave në Shqipëri është e shpjgueshme po të mbahen parasysh dy rrethana: së pari, të kihet parasysh se viset e banuara nga shqiptarë kanë qenë të pushtuara për një kohë të gjatë nga dy mbretëri sllave; së dyti, është e ditur që pushtuesit përpiqen të zëvendësojnë toponimet e mëparshme me emërtime nga gjuha e tyre” (Demiraj 1999 :129).

Në Labëri ka toponime me prapashtesat sllave: **-ov**: *Grabovë*, *Kovaçovë*, *Krivovë*, *Kumanovë*, *Kunjovë*, *Motjovë*, *Leskovë*, *Qafa e Kumarovës*, *Rehovë*, *Stërhovë*, *Strogovë*, *Tërbovë*, *Vanovë*; **-ic**: *Çerrica*, *Drashovicë*, *Dreveshnicë*, *Këndrevicë* (dredha-dredha), *Kozicë*, *Kurpicë*, *Gjezhdanica*, *Lepenicë*, *Lepotenicë*, *Mortovica*, *Nivicë*, *Pleshovicë*, *Puavicë*, *Ramicë* *Shushicë*, *Trushnicë*, **-ec**: *Gërvec*, *Goronec*, *Grashec*; **-dol**: *Vozdol*.

Me prapashtesën sllave **za-**: *Zamar* (vend në Himarë që do të thotë “përtej detit”), *Zarel*, *Përroi i Zagonit*.

Të shpeshta janë edhe toponimet që përmbajnë fjalë të huazuara nga sllavishtja, si: *Bërda*, *Brataj*, *Brodan*, *Burimi i Shqeve*, *Cerje* (majë e zezë), *Dobro*, *Drubovë* (pyll i veshur me dru), *Dushaj*, *Gllava* (vend i dalë), *Gllavat*, *Gradishtë*, *Grashecë*, *Golem*, *Gradisht*, *Moqila*, *Ploda*, *Maja e Bërdës*, *Mali i Bozhikut*, *Plloçicë*, *Pollovojkë* (shesh lufte), *Qafa e Vodës*, *Suhagorë*.

Po ashtu toponime nga emra njerëzish me origjinë sllave, si: *Ivanaj*, *Pylli i Radit*, *Qafa e Radës* etj.

Me origjinë sllave duket se janë edhe toponime si: *Bigorre*, *Borrele* (borac = pyll me pisha), *Dederonjë* (vend shëtitjesh), *Laponik*, *Mali i Çipinit* (mal i errët), *Përroi i Vëzhishtit*, *Prasek*, *Smokthinë* (vend me fiq), *Sqillovik*, *Tartar*, *Tërbaç*, *Tresenik*, *Vranisht*, *Xvori*, *Zelishtë*.

## Huazime turko-arabe

Nuk janë të pakta edhe huazimet **turko-arabe**, të cilat mund t'i gjejmë në leksikon e përgjithshëm, në emra vendesh (toponime) dhe në emra njerëzish (antroponime). Elementet turko-arabe gjenden më shumë në pjesën e brendshme të Labërisë dhe shumë më pak, mbase edhe nuk gjenden fare në zonën e Bregdetit të Poshtëm. Disa prej fjalëve të huazuara nga **arabishtja** janë edhe të njohura në areale më të gjera të shqipes, si: *aman*, *avdall*, *çull* (qilim), *haber*, *hair*, *hashure*, *matarà* (enë teneqeje për të mbartur ujë), *merak*,

*neps, noksan* ( i bezdisshëm), *nur* (bukuri), *sënduk, siklet, verem, xhade, xhenet, xhevap, xhezve* etj.

Fjalët e huazuara nga **turqishtja** përbëjnë një shtresë gjuhësore që paraqet interes gjuhësor e social-kulturor. Ndikimi i osmanishtes në gjuhën shqipe ka qenë kryesisht urban, sepse ka depërtuar fillimisht në qytete dhe vetëm shumë më vonë është përhapur edhe në zonat rurale. (Kore 2014 :197).

Disa prej huazimeve osmane gjejnë përdorim edhe në të folmen e fshatrave labe, në fakt, janë të njohura edhe më gjerë në toskërishten e në krjet shqipen, si për shembull: *alamet, aksham, ashiqare, avash, baçe, bakllava, ballajdi, bashibozuk, bedena, bakshish, basma, batak, batakçi, batall, baxhanak, bejte, biçak, biçim, birinxhi, bina, bollëk, burani, çakmak, çanak, çatma, çati, çekiç, çibuk, çifçi* (bujk), *çitjane, çurek, çyryk, damkë, damlla, dava, davet, deli* (i mirë), *derhem* (njësi matëse), *derman, dert, dervish, dollap, dolli, dollibash, duvak, dyfek, dynym, dyshek, dysheme, esnaf, evlat, ezmer, fajde, fakir, fall, fener, feste, fiqir, fitil, fustan, gafil, gajret, gajtan, gazep, gjerdek* (oda e nuses), *gjezdis, gurgule, hamall, haraç, harbi, havale* (bezdi), *helbete* (pa dyshim), *hise, hizmet, ilet, inxhi, jakë, kabull, kabuni, kadaif, kafaz, kafe, kallauz, kallëp, kallkan, kandil, kapsllëk, katil, kazma, kërbaç, kismet, kurban, kurdis, kusar, lanet, llagap, marifet, marshalla, matuf, meazallah, mejdan, melhem, mesele, midë, muhabet, muhalebi, muhamedan, mukajet, mushama, muslluk, naze, nishan, nur, oxhak, pajë, parmak, patllake, pehriz, peshqir, pusullë, qafiri, qeder, qelepër, qoshe, qulaf, sahan, sahat, salltanet, satrap, sefte, shir* (shikim), *selamet, sevda, shamata, sultiaç, taban, tabiat, takat* (fuqi), *taksirat, tavan, taze* (e freskët), *tepsi, terezi, turli, turshi, vaki, vakt, veresie, xhade, xhevahir, xhevap, xhezve, xhuma* (e premtë), *yrç* (sulm), *zagar, zengjin, zevzek, zili, zullum* etj.

Disi më të rralla dhe, ndoshta, më tipike për Labërinë dhe të folmet skajore të Jugut janë turqizma të tilla, si: *azat, boftan* (shpifje), *çivi, dedë* (gjyshe), *dehurdexhi* (roje), *futë* (përparëse), *kamare, kërdis, kopil, kravatë, kum, kumar, llaf, llapà, mandër* (stan), *mangall, matara, nursëz, qeder* (humbja), *qepaze, qibar, telendis* (turpëroj), *venome* (rregulla), *xhivar* (mbledhje), *zahar* (sheqer), *zarar, zehër* (helm).

### **Toponime që përmbajnë fjalë të huazuara nga gjuhët turko-arabe**

Pushtimi turk ndikimoi në ngulitjen e një numri të madh fjalësh dhe, në disa raste, mbi bazën e tyre janë formuar edhe emërvende (kufizuar, toponime, në fakt jo të shumta në numër, si: *Ceribash, Çiflik, Guri i Kadiut, Harapë, Karaburun, Kullxhi, Mekami, Sanxhak, Shpella e Selman Aliut, Shkalla e Turkut, Tepelenë, Vakëfe*.



## Origjina e fjalës “gunë”

Specifika etnografike e një populli përcaktohet nga një varg manifestimesh të kulturës materiale dhe shpirtërore të tij. Veshja, nga roli i saj i dobishëm dhe funksioni shoqëror që kryen, përbën një nga elementet më të rëndësishme të kulturës materiale. Po të bëjmë një analizë të hollësishme për veshjet tradicionale të Labërisë, do të shohim se ato kanë elemente të përbashkëta edhe me popujt e tjerë të Ballkanit. Këto elemente të përbashkëta e pika takimi nuk vihen re vetëm në disa aspekte të thjeshta, si në materiale, forma, ngjyra, dekore etj., por edhe në strukturën morfologjike të tyre. Kështu për shembull fjalën “gunë”, që në gjuhën shqipe e gjejmë edhe në formën “gunëza” e “guja” (Malësi e Madhe), në bullgarisht e gjejmë me format “guna” dhe “gunja”, në serbo-kroatisht e gjejmë “gun”, “gunj”, “gunjina”; në rumanisht e gjejmë “guna” e në greqisht e gjejmë “gun” (Zojzi 1966 :10).

Fjala “gunë” është mjaft e lashtë dhe mund të themi se ajo e ka fillimin me dy lëkurat e kafshës që njeriu primitiv i përdori për të mbuluar trupin para e prapa. Gustav Mejer shkruan se origjina e kësaj fjale është e errët. Shtrirja aq e gjerë e saj, në distanca aq të largëta dhe në popuj aq të ndryshëm, dëshmon për një origjinë mjaft të lashtë. Për sa i përket origjinës së kësaj fjale ka hipoteza të ndryshme, por ndër to është pranuar më tepër mendimi i Joklit, i cili mendonte se djepi i kësaj fjale do kërkuar ndër gjuhët e vjetra të Ballkanit dhe, pikërisht, nga fondi leksikor i trakishtes e ilirishtes së vjetër dhe se nga këta dy popuj të afërm në mes tyre u përhap në të gjithë pellgun e Mesdheut (Zojzi 1966 :10).

## Përfundime

Gjatë pushtimeve në periudhën e mesjetës banorët vendas në Labëri bashkëjetuan me ardhësit duke bërë asimilimin e tyre, por, gjithsesi, ata lanë një shtresë kulturore. Kontaktet dhe ndikimet kulturore të huaja, të cilat kanë lënë gjurmë në kulturën material dhe shpirtërore të banorëve vendase në Labëri, nuk mund të injorohen. Ndikimet e huaja vihen re në inventarin leksikor, emërtimet e njerëzve dhe të vendeve, si dhe në zëvendësimin e shumë fjalëve dhe emërtimeve shqipe me njësi greke, latine, sllave apo turke. Elementet prej këtyre gjuhëve kanë formuar dukuri e huazime gjuhësore në të folmen e Labërisë.

## Bibliografia

- Buda, A. (1977). *Etnografia shqiptare dhe disa problem të saj*, në “Konferenca Kombëtare e Studimeve Etnografike”, 28-30 qershor 1976, Akademia e Shkencave, Tiranë.
- Çabej, E. (1999). *Për gjenezën e literaturës shqipe*, “Studime gjuhësore”, V, Prishtinë.



- Demiraj, Sh. (1999). *Prejardhja e shqiptarëve në dritën e dëshmimeve të gjuhës shqipe*, “Shkenca”, Tiranë.
- Gjinari, J., Shkurtaç, Gj. (2003). *Dialektologjia*, Tiranë.
- Gjinari, J. (1989). *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë.
- Kore, M. (2014). *Gjirokastër, vështrim historik, gjuhësor, etnologjik*, Tiranë.
- Shkurtaç, Gj. (2001). *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, Tiranë.
- Totoni, M. (1964). *E folmja e Bregdetit të Poshtëm*, “SF”, 2, Tiranë.
- Totoni, M. (1971). *Vëzhgime rreth të folmeve të Kurveleshit*, “Dialektologjia shqiptare”, 1, Tiranë.
- Zojzi, Rr. (1966). *Guna në veshjet tradicionale të popullit shqiptar dhe të popujve të tjerë ballkanikë*, “Etnografia shqiptare”, III, Tiranë.

Zamira Alimemaj  
Kozeta Hyso

## **Balkan Borrowings in the Albanian Lab Dialect**

### Summary

Albanian dialects are traditionally divided into two groups: Geg dialects in the north, and Tosk dialects in the south. The dividing line is traditionally considered to be the Shkumbin river, which runs east-west through central Albania (at approximately the 41st parallel north). Dialects spoken in Kosovo and Macedonia are Geg dialects, while those spoken in northwestern Greece are Tosk dialects. While they are technically Tosk dialects, Arvanitika (spoken in Greece) and Arbëresh (spoken in southern Italy and Sicily) are also often considered major Albanian dialects; these dialects were brought to these areas after the Ottoman conquest of the western Balkans in the late 15th century, and they are maintained to this day. The language spoken by people of Labëria is called Labërisht and it is a variant of Tosk dialect which is one of the main dialects of Albanian language.

When speaking of Balkans, we mean that, in historical, geopolitical and linguistic sense, it constitutes a unique, although multilingual environment. Indeed, Balkans is very difficult to draw on ethnic and linguistic borders. The symbiosis and interpenetration (interaction) of various Balkan peoples, their languages and legal tradition, have played a major role in shaping the historical, cultural and legal profile of Balkans itself. The aim of this paper is to present some borrowed words from Balkan countries.

**Key words:** dialects, Albanian language, borrowed words, Lab dialect, Balkan borrowings